

Sistemi i Edukimit në Zvicër

Sistemi i Edukimit në Zvicër është një broshurë që jep udhëzime të mjaftueshme për të huajt që dëshirojnë ta njohin më mirë sistemin e edukimit në Zvicër apo dëshirojnë të studiojnë në shkollat zvicerane. Në këtë broshurë kemi përmbledhur disa materiale nga fusha e edukimit.

- **Arsimi në një vend shumëgjuhësore dhe federalist**
 - Hyrje
 - Parashkolloret
 - Shkollat fillore
 - Shkollat e detyrueshme profesionale
 - Shkollat e mesme të ulëta
 - Shkollat e mesme të larta
 - Universitetet
 - Shkollat private
 - Shkollat shqipe
- **Grafika e sistemit të edukimit**
- **Burimet e materialeve**

Arsimi në një vend shumëgjuhësore dhe federalist

Hyrje

Në Zvicër, arsimi është përgjegjësi e qeverisë duke filluar nga parashkolloret (çerdhet), deri te niveli tretësor (universitetet dhe arsimi të lartë dhe trajnimit profesional). Përgjegjësia kryesore për arsimin qëndron tek 26 kantonet. Qeveria federale dhe kantonet ndajnë përgjegjësitë për edukimin publik të detyrueshëm (maturën shkollore, arsimin dhe trajnimin profesional dhe universitetet).

Kantonet dhe komunat e tyre lokale financojnë rreth 87% (2005) të shpenzimeve në arsimin publik. Zvicra ka një sistem të decentralizuar në masë të madhe të arsimit. Shumica e vendimeve për drejtimin e shkollave fillore dhe të mesme merren në nivel kantonial dhe gjithashtu kantonet sigurojnë pjesën më të madhe të financimit.

Zvicra nuk ka një ministër federal të arsimit. Megjithatë, disa aspekte organizative të sistemit të arsimit zbatohen në të gjithë vendin. Këto përfshijnë kohëzgjatjen e vitit shkollor, dhe numrin e viteve të shkollimit të detyrueshëm.

Në fusha të tjera kantonet, dhe madje edhe komunat, tradicionalisht gëzojnë një shkallë të lartë të autonomisë.

Secili kanton e ka udhëheqsin e vet të edukimit, të cilët së bashku përbëjnë Konferencën Federale të Ministrave të Kantonëve të Arsimit (në ger: EDK www.edk.ch).

EDK luan një rol të rëndësishëm në diskutimin dhe koordinimin e politikës së arsimit, dhe disa vlera të caktuara të rëndësishme.

Parashkolloret

Shumica e studentëve në Zvicër (95%) përfundojnë shkollimin para-shkollor dhe të detyrueshme në shkollat shtetërore në komunën në të cilën jetojnë ndërsa 5% ndjekin mësimet tek shkollat private.

Shkollat shtetërore luajnë një rol të rëndësishëm në integrimin e fëmijëve që kanë prejardhje të ndryshme sociale, gjuhësore dhe kulturore ku të gjithë marrin pjesë në një shkollë.

Shkollat janë përgjegjësi e kantoneve. Komunitatet lokale organizojnë mënyrën në të cilën shkollat veprojnë sepse edukimi ka rrënjët në nivel lokal, zgjidhje individuale mund të zbatohet në çdo vend.

Të gjitha kantonet sigurojnë 1-2 vjet shkollim parashkollor falas (qerdhet e fëmijëve), kantoni i Ticinos ofron 3 vjet.

Struktura federale dhe e decentralizuar e arsimit parashkollor dhe arsimit të detyruar e bën të mundur për t'u marrë në mënyrë adekuate me dallimet kulturore në një vend shumëgjuhësor dhe traditat e saj të veçanta-rajonale në shkollë. Kërkesat kombëtare zbatohen për parametrat kryesorë të (hyrja e moshës, gjatësia e shkollimit të detyruar). Këto kërkesa do të zgjerohen gjatë viteve të ardhshme duke u bazuar në një marrëveshje ndër-kantonale të EDK-së në harmonizimin e arsimit të detyrueshëm (HarmoS). Për parashkolloret 2 vite do të bëhet i detyrueshëm gjatë harmonizimit nëpërmjet këtij procesi.

Shkollat fillore

Shkollimi i detyruar fillor fillon në moshën 6 vjeçare dhe vazhdon për nëntë vite shkollimi. Shumica e shkollave fillore ndjekin klasat prej 1-6. Kjo është pasuar nga niveli i ulët (klasat 7-9) ku nxënësit vijojnë mësimin në grupe bazuar në performancë, në të gjitha lëndët ose në disa lëndë.

Gjuha e mësimi është gjermanisht, frëngjisht, italisht ose gjuhë romane, në varësi të rajonit të gjuhës, edhe pse në gjuhën romane komunitetet janë një rast i veçantë. Tradicionalisht, mësimi i gjuhëve, ka një rol të rëndësishëm në Zvicër. Të gjithë studentët së paku mësojnë dy gjuhë tjera gjatë shkollimit të tyre të detyrueshëm. Në përgjithësi kjo është një nga gjuhët tjera që fliten në Zvicër dhe gjuha angleze.

Shkollat e mesme të ulëta

Në fund të nivelit fillor, një fëmijë duhet të vazhdojë për në shkollimin e mesëm të ulët, i cili zgjatë për 3-5 vjet, në varësi të kantonit dhe komunës. Ky shkollim është i detyrueshëm dhe falas i cili shënon fazën përfundimtare të arsimit të detyrueshëm. Fëmijët në këto klasa priren të jenë midis 12 dhe 15 vjeç. Nuk ka asnjë provim në mbarë vendin në fund të klasës së 9 (viti i fundit) kështu që studentët nuk marrin asnjë certifikat të diplomimit.

Fëmijët ndahen në bazë të performancës, rekomandimeve të mësuesve dhe ndoshta një test. Testimi, sjellja, dhe qëndrimet e punës janë përdorur për të përcaktuar nëse fëmija vazhdon tek niveli i ardhshëm.

Shkolla e mesme e ulët ofron arsimin bazë, të përgjithshme (si matematikë, gjeografi, dhe dy gjuhë të huaja). Studentët në këtë nivel përgatiten për arsimin profesional apo për të vazhduar arsimimin në një shkollë të mesme të lartë.

Për më shumë informacione rreth këtyre qeshtjeve ju lutem vizitoni webfaqen www.educa.ch

Shkollat e mesme të larta

Edukimi në shkollën e mesme të lartë nuk është i detyrueshëm dhe është i ndarë në dy grupe: Arsimin e përgjithshëm ose profesional. Në të gjitha, 90% e studentëve në Zvicër diplomojn në këtë nivel. Një e treta e studentëve shkojnë në një shkollë të maturës (quhet “Gjimnaz”). Shumica e studentëve marrin mësim dhe aftësim profesional. Për informacion mbi këtë të fundit, ju lutem shih seksionin mbi jetën e punës tek www.unica.ch.

Shkollat e maturës janë të rregulluara bashkërisht nga autoritetet kantonale dhe federale, por autoritetet kantonale vendosin shpesh kërkesat e pranimit. Nxënësit me nota të jashtëzakonshme nga shkolla e mesme e ulët mund të pranohen në një shkollë të maturës, pa hyr në provim në disa raste. Përndryshe një provim pranues është një komponentë kritik për të përcaktuar nëse një student mund të studiojë në një shkollë të tillë.

Studentët duhet të bëjnë një lloj të temës (punë diplome), si dhe të kalojnë një seri të provimeve që, nëse i përfundojnë me sukses, rezultatat në një certifikatë të maturës e lejon pranimin në universitetet kantonale dhe institutet federale të teknologjisë. Analiza të caktuara mund të aplikojnë, për shembull, nëse një student frengjisht-folës dëshiron të studiojë mjekësi në një rajon gjerman-folës.

Për më shumë rreth shkollave të maturës, duke përfshirë se si të rriturit mund të fitojnë një certifikatë të maturës, ju lutem shihni webfaqen e serverit të edukimit www.unica.ch

Shkollat e detyrueshme profesionale

Legjislacionit zviceran (ndërkantonal apo kombëtar) formon bazën për llojin e arsimit në fushën e arsimit të detyrueshëm (niveli i mesëm i lartë dhe të nivelit tretësor). Kantonet janë përgjegjëse për zbatimin e këtij legjislacioni dhe janë përgjegjës për organizimin e shkollave. Të vetmet përjashtime janë institutet federale zvicerane të teknologjisë, të cilat janë në krye të autoriteteve federale.

Në Zvicër 90% e të rinjve përfundojnë arsimin e mesëm të lartë në moshën 18 ose 19 e cila u lejon atyre të fillojnë të punojë, për të kaluar në një kolegji të trajnimit të lartë profesional ose - me një maturë / diplomë - për të vazhduar arsimin e tyre në një universitet publik ose një universitet të shkencave të aplikuara.

Në vijim disa tiparet të veçanta të sistemit arsimor zviceran:

- Depërtueshmëria:
Ka shumë mënyra për të hyrë ose bërë transferim në një program trajnimi ose në shkollë apo për të marrë pjesë në një program trajnimi të arritur.
- Ka qasje të hapur për llojet e ndryshme të arsimit:
Kushdo që ka kualifikimet e nevojshme në përgjithësi mund të marrë pjesë në kursin e zgjedhjes, pjesëmarrja në universitet mund të jetë zgjedhur me vullnet (lirshëm).
Arsimi dhe aftësimi profesional është subjekt i disa kufizimeve për shkak të numrit të madh të studentëve për fusha të caktuara profesionale.
- Qasja në shkollat mjekësore është e kufizuar edhe në një masë të caktuar.
- Diplomat janë të njohura në të gjithë Zvicrën, duke lehtësuar lëvizjen kombëtare dhe ndërkombëtare.

Universitetet

Zvicra ka një numër të madhë të universiteteve, instituteve teknologjike dhe qendra tjera të të mësuarit që e vënë sistemin arsimor ndër vendet më të mira në botë.

Arsimi në përgjithësi është i lirë në krahasim me disa shtete që kanë nivel të lartë të edukimit bazuar në standartet që i ka Zvicra duke i marrur shkollat publike të cilat i mbështet shteti zviceran. Zvicra ka 12 universitete publike duke përfshirë edhe dy institute federale të teknologjisë, të cilët e rendisin vetvetën ndër më të mirët në rang botëror për shkencë dhe inxhinieri.

Tetë universitete të shkencave të aplikuara dhe 15 universitete të arsimimit të mësuesve janë jashtë sistemit publik të arsimit.

Studentet zakonisht mësojnë në gjuhët vendase (gjermanisht, frëngjisht ose italisht), ndërsa gjuha angleze po bëhet gjithnjë e më shumë e zakonshme në programet universitare.

Për një listë të programeve të ofruara në anglisht, ju lutem vizitoni webfaqen www.crus.ch

Shkollat private

Zvicra gjithashtu ka disa nga shkollat private më të mirat dhe më të shtrenjta në botë duke filluar nga qerdhët e fëmijëve e deri tek universitetet. Për më shumë informacione vizitoni federatën zvicerane të shkollave private www.swiss-schools.ch

Shkollat shqipe

Me qëllim të një organizimi dhe bashkëpunimi më të afërt ndërmjet shkollave në gjuhën shqipe që veprimtarit e tyre i kryejnë pothuajse në të gjitha komunat e Zvicrës ku jetojnë shqiptarët ne do të kushtojmë një rëndësi të veçantë këtyre shkollave.

Si informacion kryesor ne do të sigurojmë se paku adresat dhe informacionet tjera kontaktuese ku pastaj kohë pas kohe do të shkruajmë edhe rreth historisë dhe veprimtarive tjera nga këto shkolla duke ju sjellur tek ju edhe punime të ndryshme nga nxënësit e këtyre shkollave.

Njoftimet dhe orarin mësimor nëpër këto shkolla do të mundohemi ta sigurojmë nga të gjitha shkollat në bashkëpunim me arsimtarët dhe organizatat që veprojnë në përkrahjen e integritetit të shqiptarëve.



Në të ardhmen ne do të krijojmë edhe një rrjet të bashkëpunimit me shkollat tjera nga shtete të ndryshme ku shkëmbimi i përvojave do të ndikojë në një zhvillim dhe stimulim të mëtutjeshëm në ruajtjen e vlerave kulturore nga gjeneratat e ardhshme.

Organizimin e shkollave shqipe të mësimin plotësues në Zvicër e bën Lidhja e Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë "Naim Frashëri" shkurt LAPSH "Naim Frashëri" www.lapsh-ch.com

Rreth shkollave shqipe në Zvicër ne kemi përgatitur një kategori të veçantë tek seksioni Shqiptarët

Duke shpresuar se të gjithë arsimtarët, prindërit dhe nxënësit do të mebeten të knaqur me shërbimet tona që do të sjellim tek ju, jeni të mirëseardhur për bashkëpunim, sugjerime apo vërjetje tjera dhe ne do të mundohemi që kërkesave tuaja se paku t'ju përgjigjemi.

SISTEMI I EDUKIMIT NË ZVICËR




Ky diagram është bazuar nga webfaqja e EDK-së www.edk.ch



Diplomë

Tranzicion:

- 1 Diplomë => Universitetet e shkencave të aplikuara (trajnim praktik)
- 2 Diplomë Federale Profesional => Universitetet (kualifikime shtesë)



** Diplomë e specializuar e programit

*** EPA – Edukimi Profesional dhe Afhtësimi

Shkollimi i detyrueshëm.

Ky diagram tregon strukturën aktuale të sistemit të edukimit.



Qëllimi i kantoneve që të harmonizoj strukturat e edukimit në shkollat e detyrueshme.

ISCED

Diagrami përmban një link të ISCED (International Standard Classification of Education – Klasifikimi i Standarteve Ndërkombëtare të Edukimit)

www.uis.unesco.org

ISCED-ja përcakton një kod ndërkombëtar (ISCED 0 to ISCED 6) për çdo nivel të arsimit. Kjo siguron krahasueshmërinë ndërkombëtare të niveleve arsimore.

	ISCED 6
	ISCED 5A + 5B
	ISCED 4A + 4B
	ISCED 3A-C
	ISCED 2A
	ISCED 1
	ISCED 0

Burimet e materialeve

Të gjitha këto burime janë të bazuara nga

EDK - Konferenca Federale e Ministrave të Kantonëve të Arsimit www.edk.ch

Swissinfo www.swissinfo.ch

Konfederata e Rektorëve të Universiteteve Zvicrane www.crus.ch

Përshtati: Faton Krasniqi

© Janar 2012